

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. B., nga Skenderaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I. D., avokat nga Glogoci, kundër të paditurës Fondi i Garancisë së Kosovës tani Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V. H., nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, CA.nr.241/2014 datë 8.3.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.6.2017, merr këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, CA.nr.241/2014 datë 8.3.2017, në pjesën e aktgjykimit e cila ka të bëjë me zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 10% dhe lidhur me shëmtimin në shkallë të mesme, ndërsa në pjesën tjetër aktgjykimi i kundërshtuar mbetet i pa prekur.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, CA.nr.241/2014 datë 8.3.2017, është refuzuar pjesërisht si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Mitrovicë, Dega në Skenderaj, C.nr. 0086/2011, me përjashtim të shumës së gjykuar në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor dhe shëmtimit në të cilën pjesë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ndryshuar ashtu që është detyruar e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo pasuror: për zvogëlim të aktivitetit jetësor t'ia paguaj shumën prej 3000 €, ndërsa në emër të shëmtimit shumën prej 2000 €. Me aktgjykimin e cekur është ndryshuar vendimi për kamatëvonesën si në vijim: Me kamatëvonesë si për mjetet e

depozituara në kursim te Bankat Komerciale në Kosovë pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 14.2.2013, si ditë e marrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë e deri në pagesën definitive. Ndërsa në pjesën tjetër përtej shumës së gjykuar e në shumën prej 2.500€, kërkesëpadia e paditësit, kundër të paditurës si dhe kamatëvonesa mbi këtë shumë, janë refuzuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë që ka të bëjë me rentën si dhe vendimi për shpenzimet procedurale është prishë dhe çështja i është kthyer gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, ndërsa pjesa IV e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ka mbetur e pa ndryshuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin, ta ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë në pjesën e aktgjykimit e cila ka të bëjë me zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 10% dhe lidhur me shëmtimin në shkallë të mesme, ashtu që në këtë pjesë të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ose aktgjykimi i kundërshtuar të priset dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave ka vërtetuar se më datë 23.11.2010, vozitësi M. (E) M. duke drejtuar automjetin e markës Mercedes 1735, me targë të regjistrimit ..., duke lëvizur nga drejtimi i Drenasit në drejtim të Skenderajt, me pjesën e rimorkios së kamionit e ka goditur një shufër metalike e cila ka qenë e vendosur në kamionin me targë ..., i parkuar afër rrugës, e cila shufër pastaj e ka goditur punëtorin B.B., (këtu paditësin), me ç'rast i njëjti pëson sindrom të tronditjes - ndrydhje të trurit, ndrydhje e indeve të buta të regjionit të qafës, plagë shqyese ndrydhëse në regjionin ballor të djathtë dhe të kapakut të syrit të djathtë, plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e hundës dhe regjionin e artikulationit të

kërdhokullës së majtë, të cilat lëndime janë të natyrës së rëndë trupore, që si pasojë të paditësi kanë shkaktuar dhimbje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallë prej 10% , shëmtim në shkallë të mesme, i janë shkaktuar shpenzime për shërim, ka pas nevojë për ndihmë nga personi tjetër, ushqim të përforcuar dhe i është dëmtuar gardëroba.

Me përgjigjen në padi e paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesëpadisë, por vetëm lartësinë e shumës së kërkuar për kompensim të dëmit.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material e material, është shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës pjesërisht ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, shpenzimet e mjekimit ndihmën nga personi tjetër, ushqimin e përforcuar, dëmtimin e gardërobës, ndërsa lidhur me zvogëlimin e aktivitetit jetësor në shkallën prej 10%, shëmtimin në shkallë të mesme dhe lidhur me kumatën ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale, për të cilën arsye ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi. Pjesën e aktgjykimit lidhur me zvogëlimin e aftësisë punuese në shkallë prej 20% dhe shpenzimet e procedurës kontestimore ka vlerësuar se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkelje thelbësore, për të cilin shkak në këtë pjesë aktgjykimin e ka kthyer për rigjykim, e të cilën pjesë kjo Gjykatë e revizionit nuk e shqyrtoi.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit pjesërisht është e bazuar. Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, kur ka gjykuar shumat

për kompensim të cilat duhet t'i paguajë e paditura paditësit, të cilat arsye i mbështetë edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Pretendimin e revizionit se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 182 par.2 pika (n) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është i pabazuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë, nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe përmban arsye të mjaftueshme për gjykim të drejtë e të ligjshëm. Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë mbi gjendjen e tillë faktike drejt ka zbatuar dispozitat e nenit 200 të LMD -ës lidhur me nenin 323 të LPK -ës, përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit jo material për zvogëlimin e aktivitetit jetësor në shkallë prej 10% në shumën prej 3000 € dhe për shëmtim në shkallë të mesme në shumën prej 2000 €, ngase, këto shuma janë gjykuar në bazë të ekspertizës mjekësore nga eksperti Dr. A. K. – neurokirurg dhe Dr. N. M. - psikiatre. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD duhet të kujdeset për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me te mos të favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimit shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditësit, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor dhe shëmtimin në shkallë të mesme, si dhe praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shuma e caktuar e shpërblimit të dëmit paditësit nga ana e gjykatës së shkallës së dytë sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është reale dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas kësaj dispozite, për të cilën arsye gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Pretendimin e paditësit të cekur në revizion se shumat për kompensim për zvogëlim të aktiviteti jetësor dhe shëmtim, të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë janë të drejta dhe në proporcion me lëndimet trupore, kjo Gjykatë i shqyrtoi por të njëjtat nuk patën ndikim për të

vendosur ndryshe, ngase kjo Gjykatë e revizionit vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjykuar shumat e cekura si në dispozitivin e aktgjykimit lidhur me zvogëlimin e aktivitetit

jetësor dhe lidhur me shëmtimin trupor, të cilat arsye i mbështet edhe Gjykata Supreme, sepse të njëjtat janë caktuar në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësor dhe në bazë të praktikës gjyqësore, duke aplikuar dispozitën ligjore të cekur më lartë, andaj pretendimi i cekur u vlerësua si i pabazuar.

Pjesën tjetër të aktgjykimit Gjykata Supreme e Kosovës nuk e shqyrtoi pasi që e njëjta nuk u kundërshtuar me revizion.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 13.6.2017, Rev.nr.148/2017

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku